



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:175330  
Datë: 29.05.2024  
Numri i dokumentit: 05751350

**Ac.nr.8770/22**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli e Bujar Muzaqi - anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F.RR nga ,, , të cilën sipas autorizimit e përfaqëson T.I avokat nga ,, , rruga “,, ,” nr., ,, , kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Scardian” me seli në Prishtinë, Rr. “Perandori Justinian”, nr.69, të cilin e përfaqëson zyrtari ligjor SH.R nga ,, , me objekt kontesti kompensimi i dëmit material dhe jo material, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - departamenti i përgjithshëm, C.nr.2436/20, të datës 25.10.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën **29.05.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**HUDHET POSHTË e palejueshme** ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Scardian” me seli në Prishtinë, e parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - departamenti i përgjithshëm, C.nr.2436/20, të datës 25.10.2022.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.2436/20, të datës 25.10.2022, në pikën **I** të dispozitivit e ka miratuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditëses F.RR nga ,, , dhe ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve “Scardian” me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material që ka pësuar paditësja nga lëndimet e marra nga aksidenti i trafikut të datës 11.11.2020, t’ia paguajë shumat e specifikuara me sa vijon ashtu që: A. Në emër të kompensimit të dëmit material, t’ia paguaj shumat e specifikuara më poshtë: Në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë për 7 ditë, shumën prej 100 €, në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 120 €; me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë 11.12.2020, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita

e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm. B. Në emër të kompensimit të dëmit jo material, t'ia paguaj shumat e specifikuar si më poshtë: Në emër të vuajtjeve shpirtërore për dhimbjet fizike-trupore, shumën prej 1,980.00 €, në emër të vuajtjeve shpirtërore për frikën e përjetuar, shumën prej 1,480.00 €, në vazhdim e ka detyruar të paditurën që paditëses të gjitha shumat e gjykuara në emër të dëmit jo material, t'ia paguaj me kamatë ligjore-vjetore prej 8%, duke filluar nga data 25.10.2022, si datë e nxjerrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë. Në pikën II të dispozitivit pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses F.RR nga ,, , për kompensimin e dëmit material dhe jo material, mbi shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin nën pikën I të këtij aktgjykimi, e ka refuzuar si të pa bazuar, edhe atë: shumën prej 50 €, në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë, shumën prej 80 € në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 100.00 € në emër të vuajtjeve shpirtërore për dhimbjet fizike-trupore, shumën prej 200 € në emër të frikës së përjetuar. Në pikën III të dispozitivit e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses F.RR nga ,, , me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimit “Scardian” me seli në Prishtinë, që për kompensimin e dëmit për shkak të shpenzimeve për barna në bazë të faturave, t'ia paguaj paditëses shumën prej 38.40 €. Në pikën IV të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Kompania e Sigurimit “Scardian” me seli në Prishtinë, që përfaqësuesit me autorizim të paditësit av.T.I nga ,, , t'ia paguaj shpenzimet procedurale, dhe atë në lartësi të përgjithshme prej 716.40 euro, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura Kompania e Sigurimit “Scardian” me seli në Prishtinë, në afatin ligjor ka parashtuar ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të *shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që të aprovohet ankesa ashtu që të prishet aktgjykimi i atakuar dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Në ndërkohë e paditura, përkatësisht i autorizuari i tij me parashtresën e datës 29.03.2024 (derisa lënda ka qenë në Gjykatën e Apelit), e ka njoftuar gjykatën e shkallës së dytë se e njëjta në këtë çështje juridike kontestimore e bënë tërheqjen e ankesës, me arsyetimin se me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 dhe 195, të LPK-së, gjeti se:

- *Ankesa e paditësit është e palejueshme.*

Këtë qëndrim gjykata e mori duke u bazuar në dispozitat e nenit 196 të LPK-së, ku parashihet se “*Ankesën e vonuar, jo të plotë, apo të palejueshme, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë me aktvendim, po që se nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës siç është parashikuar në nenin 186*”.

Poashtu në nenin 186.3 të të njëjtit ligj, shprehimisht parashihet se “*Ankesa është e palejueshme po që se e ka paraqitur personi që nuk është i autorizuar për paraqitjen e saj, apo personi që ka hequr dorë nga e drejta e ankimit apo që e ka tërhequr ankesën e paraqitur, apo në qoftë se*

*personi që e ka paraqitur ankesën nuk ka interes juridik për paraqitjen e ankesës”*. Po ashtu me nenin 177 parag.2 të LPK-së parashihet se “

Andaj gjykata në kuptim të nenit 195.1 pika a) lidhur me nenin 196 të LPK-së, e hodhi poshtë si të palejuar ankesën e paditësit, pasi që i njëjti e ka tërhequr ankesën e parashtruar.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv, në kuptim të nenit 195.1 pika a) lidhur me nenin 196 dhe 177.2 të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.8770/22, datë 29.05.2024**

**Kryetari i kolegjit - gjyqtari**  
**Arsim Hamzaj**